

COVID-19 dhe shëndeti dhe siguria në punë – Biznesi i vogël

Vlerësimi dhe menaxhim i rreziqeve

COVID-19 ka sfiduar mënyrën në të cilën të gjithë ne jetojmë dhe punojmë. Por bota e biznesit të vogël vazhdon të funksionon.

Një vlerësim rreziku i shëndetit dhe sigurisë në punë është një hap esencial për bizneset e vogla, për të identifikuar dhe menaxhuar rreziqet për ju, stafin dhe klientët tuaj.

Kur bëni një vlerësim rreziku, parashtroni vetes pyetjen:

- Cilët janë rreziqet?
- Çfarë dëmi mund t'i shkakton dikujt, dhe sa ka gjasa të ndodh?
- Cili është niveli i rrezikut?
- Çfarë mund të bëj unë për të menaxhuar rreziqet?
- Si do të shqyrtohet dhe monitorohet rreziku, për t'u siguruar se masat e kontrollit janë duke funksionuar, dhe si do të bëhet kontrolli për rreziqe të reja?

Menaxhimi i rrezikut është në zhvillim e sipër – sigurohuni të vlerësoni rreziqe të reja apo të ndryshuar që dalin nga COVID-19, sikurse rreziqet nga një agresion klienti, kërkesës së madhe të punës apo të punuarit në izolim.

Ju duhet të bisedoni me punëtorët tuaj. Ju bashkë mund të identifikoni rreziqet dhe të gjeni se si t'i menaxhoni ato.

Bashkë të mbajmë funksionale botën e biznesit të vogël. Për më shumë informacione, drejtohuni në uebfaqen - safeworkaustralia.gov.au.

Distancimi fizik

Rreziku i ekspozimit në COVID-19 është rritur kur punohet në kontakt të afërt me të tjerët. Aty ku është e mundshme, praktikoni distancimin fizik.

Konsideroni:

- Ridizajnimin e organizimit të vendit të punës.
- Mbajtjen e takimeve jo të drejtpërdrejta.
- Reduktimin e numrit të njerëzve në hapësira të përbashkëta.
- Menaxhoni radhët dhe numrat e klientëve.

Dhe aty ku është e mundshme, leni kohë në mes takimeve për të limituar interakcionin fizik dhe sigurohuni që punëtorët të kenë veglat apo mjetet e tyre personale.

Për udhëzim industrial për sa i përket COVID-19, drejtohuni tek safeworkaustralia.gov.au.

Pastrimi i vendit tuaj të punës

COVID-19 përhapet përmes spërkalave kur një person i infektuar kollitet apo teshtitet.

Njerëzit mund ta marrin COVID-19 përmes prekjes së një sipërfaqeje që ka mikrobe mbi atë.

Sigurohuni që vendi juaj i punës të pastrohet së paku një herë në ditë me detergjent dhe ujë.

Pasi që sipërfaqja të pastrohet, mund ta dezinfektoni atë.

Jepni prioritet sipërfaqeve që më shpesh preken.

Nëse keni në punë një rast me COVID-19, vendi juaj i punës do të duhet të pastrohet plotësisht dhe dezinfektohet para se të kthehen njerëzit.

Për udhëzim industrial për sa i përket COVID-19, drejtohuni tek safeworkaustralia.gov.au.

Uebfaqja e Australisë për Siguri në Punë nga COVID-19

Siguria në Punë e Australisë (Safe Work Australia) ka zhvilluar një udhëzim të ri për të ndihmuar bizneset e vogla të kuptojnë obligimet për shëndetin dhe sigurinë në punë, dhe për të menaxhuar rreziqet që dalin nga COVID-19.

safeworkaustralia.gov.au ka informacione për temat siç është se si të bëni një vlerësim rreziku, distancimin fizik, higjienën, mjete mbrojtëse personale, shëndetin mental dhe pastrimin.

Përdorni veglën për të filtruar përmbajtjen që më lehtë të gjeni informacione që janë relevante për biznesin apo industrinë tuaj të vogël, si dhe për resurse praktike, siç janë çeklistat dhe posteret në vendin e punës.

Për udhëzim specifik për industrinë tuaj, drejtohuni online tani - safeworkaustralia.gov.au.